



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.429/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës për Raundin e Dytë për Kryetar Komune që janë mbajtur më datë 09.11.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

I.PRANOHET e BAZUAR ankesa: ZL.Anr.429/2025 e datës 09.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 09.11.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK në të cilën thekson se më datë 09.11.2025, ditën e zgjedhjeve lokale, aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) Doni Beshiri, në Mitrovicë ka bërë thirrje publike për të votuar kandidatin e këtij subjekti politik për kryetar të Komunës së Mitrovicës, z. Faton Peci. Ky aktivist, përmes një postimi në facebook, ka shkruar: "Vetëvendosja në jug është garancia e sovraniteti në veri, 100 është arsyeja pse mbështetja për Faton Pecin është strategjike, jo thjesht/ politike. " Ky veprim përbën shkelje të qartë të nenit mbi heshtjen zgjedhore, e cila ndalon çdo formë të fushatës apo thirrjeje për votim për subjekte ose kandidatë politikë në ditën e zgjedhjeve. Për këtë arsye, kërkoj nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) që të shqyrtojë këtë rast dhe të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj subjektit politik

Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në përputhje me nenet përkatëse të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për periudhën e heshtjes zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik LVV ka kundërshtuar pretendimet në ankesë me arsyetimin se ankesa e paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me postimin e z. Doni Beshiri është e pa bazë. Sqarojmë se z. Beshiri nuk është pjesë e strukturave të Lëvizjes Vetëvendosje dhe nuk ushtron asnjë funksion në emër të subjektit. Përkundrazi, ai është i suspenduar nga aktivitetet e lëvizjes që prej katër vitesh dhe nuk përfaqëson asnjë organ apo degë të saj. Çdo postim i bërë prej tij është shprehje personale dhe nuk mund t'i atribuohet subjektit politik në mungesë të çdo marrëdhënieje organizative apo përfaqësuese. Përgjegjësia për veprimet gjatë fushatës bie mbi subjektin politik ose përfaqësuesit e tij zyrtarë. Si rrjedhojë, një qytetar i thjeshtë, pa status brenda strukturës partiake, nuk mund të konsiderohet bartës i përgjegjësisë zgjedhore të subjektit. Kjo ankesë është e pabazuar në ligj dhe duhet të hidhet poshtë si e tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

- Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur, vlerësoj se pretendimet e subjekti politik PDK, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet "Bërja fushatë në çfarëdo mënyre" Si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, ku parashihet se *"nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi"*.

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh *"Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme."* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në llogarinë e rrjetit social Facebook të Doni Beshiri shihet qarte se mbështetësi i subjektit politik i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) Doni Beshiri, në Mitrovicë me datë 09 Nëntor 2025, në ditën e votimit në rrjetin e tij social të Facebookut përmes një postimit ka bërë publikimin duke bërë thirrje publike për të votuar kandidatin e këtij subjekti politik për kryetar të Komunës së Mitrovicës, Faton Peci në të cilin ka shkruar: *"Vetëvendosja në jug është garancia e sovraniteti në veri, 100 është arsyeja pse mbështetja për Faton Pecin është strategjike, jo thjesht/ politike"*.

Megjithatë, duke u bazuar në provat e paraqitura në ankesë, si dhe nga hetimi i kryer nga PZAP-i, paneli ka vlerësuar se Doni Beshiri, me postimin e bërë në ditën e votimit, mund të ketë ndikuar tek votuesit, dhe se një veprim i tillë është i ndaluar sipas dispozitave të LZP-se.

Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, pasi veprimi është bërë në rrjetin social dhe ka pasur për qëllim të ndikimit tek votuesit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtuar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores zgjedhore 07/2024, po ashtu fakti se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në ditën e votimit. Ndërsa lidhur me pretendimet në përgjigje në ankesë se z.Beshiri nuk është pjesë e strukturave të Lëvizjes Vetëvendosje, se nuk ushtron asnjë funksion në emër të subjektit dhe se postimi i bërë prej tij është shprehje personale e cila nuk mund t'i atribuohet subjektit politik, Paneli vlerëson se arsyetimet e theksuara si më lartë, nuk e përjashton nga përgjegjësia subjektin politik LVV pasi që i njëjti Doni Beshiri nga shume postime e bëra në facebook vërtetohet në mënyrë të qartë se është mbështetës dhe përkrahës i subjektit politik LVV, si dhe i kandidatit të saj për kryetar komune në Mitrovicën e Jugut, Faton Peci.

Neni 33 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton përgjegjësit e subjekteve politike, mbështetësve të tyre dhe kandidatëve, ku paragrafi 3 i këtij neni thekson se subjektet politike i informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij kodi, ndërsa paragrafi 5 thekson se subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre. Andaj në rastet e tilla të njëjtit kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit zgjedhor.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.429/2025, datë 12.11.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.